REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 120/17, 124/17
Datë/Datum 22.06.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BODY

PSH Nr. 120/17
124/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z. Blerim Dina- Kryetar, z. Ekrem Salihu - Referues, z. Tefik Sylejmani - Anëtar, z.Nuhi Paçrizi- Anëtar, z. Goran Milenković - Anëtar duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE "Poligoni i shenjëtarisë Katana'' sh. p. k – Obiliq, si dhe OE "Sodex Group"Sh. p. k- Prishtinë, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me jelek anti-plumb'', me nr prok: "214/16/134/111'', të iniciuar nga AK– Policia e Kosovës (PK), më datën 30 Maj 2017, me votim shumicë mori këtë:

V E N D I M

I. **HEDHET** poshtë si e palejuar ankesa OE ankues "Poligoni i shenjëtarisë Katana'' sh. p. k – Obiliq, si dhe ankesa e OE ankues "Sodex Group" Sh. p. k- Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me jelek anti-plumb''me nr prok: "214/16/134/111'', për shkak të mungesës së dëshmimit të interesit Juridiko Material konform nenit 111 par. 1 pika 1 deri në pikën 8, lidhur me nenin 4.1.26 të LPP-së, sepse të njëjtit janë të papërgjegjshëm, dhe se në asnjë rrethanë edhe po të kthehej ky aktivitet në rivlerësim të njëjtit nuk mund të shpalleshin fitues të këtij aktiviteti të prokurimit të iniciuar nga autoriteti kontraktues - Policia e Kosovës.

II. **VËRTETOHET,** vendimi i AK-së, për dhënie te kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me jelek anti-plumb'', me nr prok: "214/16/134/111''i iniciuar nga autoritetit kontraktues - Policia e Kosovës.

III. Autoriteti Kontraktues në aftë prej **10** ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit .

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se pretendimet ankimore të operatorëve ekonomik ankues OE "Poligoni i shenjëtarisë "Katana sh. p. k"- Obiliç, si dhe OE "Sodex Group Sh.p.k"- Prishtinë janë hedhur si të palejuara, i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë është bërë me dt:27.07.2016, ndërsa hapja e ofertave është bërë me dt:29.07.2016, ndërsa në këtë aktivitet të prokurimit kanë marr pjesë gjashtë operatorë ekonomik.

Njoftimi për dhënie të kontratës është bërë me dt:31.03.2017, ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "All Zone& Seyntex& Proccm sh. p. k"

Kërkesa për rishqyrtim nga ana e operatorit ekonomik "Poligoni i shenjëtarisë Katana sh. p. k" - Obiliq, është bërë me dt:05.04.2017.

Si dhe kërkesa për rishqyrtim nga ana e operatorit ekonomik Sodex Group"Sh.p. k- Prishtinë është bërë me dt :05.04.2017

Vendimi në lidhje me këto dy kërkesa për rishqyrtim të cilat janë refuzuar është marr me dt:05.04.2017

Operatori ekonomik "Poligoni i shenjëtarisë Katana'' sh. p. k – Obiliq, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me datën 21.04. 2017 me nr. protokolli 120/17, kundër vendimit të AK-së me titull: "Furnizim me jelek anti-plumb'', me nr prok: "214/16/134/111'',, duke pretenduar se

autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- neni 6 i LPP-së i LPP-së (Ekonomiciteti dhe Efikasiteti)
- nenin 7 i LPP-së i LPP-së (Barazia në trajtim/Jo diskriminimi)
- neni 59 i LPP-së (Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve).
- nenin 64 i LPP-së i LPP-së (Dheshmit e Kresave)
- nenin 67 i LPP-së i LPP-së (Provat Shkresor)
- neni 69 pika 1 dhe 4 i LPP-së(Aftësitë teknike dhe/ose profesionale.

Operatori ekonomik "Sodex Group"Sh. p. k- Prishtinë si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, më 21 prill 2017 me nr. 124/17, kundër vendimit të AK-së me titull: "Furnizim me jelek anti-plumb'', me nr prok: "214/16/134/111'', duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- nenin 7 i LPP-së i LPP-së (Barazia në trajtim/Jo diskriminimi)
- nenin 13 i LPP-së i LPP-së (Përdorimi i gjuhëve ne dokumentet e prokurimit)
- nenin 56 i LPP-së i LPP-së (Dispozitat e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve)
- neni 59 i LPP-së (Ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve).
- nenin 60 i LPP-së i LPP-së (Kriteret për dhënien e kontratës)
- neni 69 i LPP-së (Aftësitë teknike dhe/ose profesionale)
- nenin 71 i LPP-së i LPP-së (Grupet e Operatoreve ekonomik dhe operatoret e huaj)

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palëve ankimore.

Eksperti shqyrtues - teknik përmes raportit të datës 18 maj 2017, vlerëson si pjesërisht të bazuar, ankesat e OE ankues Poligoni i Shenjëtarisë "Katana" Sh.P.K dhe OE "Sodex Group" SH.P.K. Bazuar në gjitha konstatimet dhe sqarimet e dhëna gjatë shqyrtimit të kësaj lënde, eksperti shqyrtues/teknik në përputhje me nenin 114 pika 2 të LPP-së, rekomandon që autoriteti kontraktues–Policia e Kosovës, ta Anuloj aktivitetin e prokurimit "Furnizim me Jelek Anti-plumb"me nr. prokurimi 21416 134 111, për mungesë të ofertave të përgjegjëshme, në përputhje me dispozitat e LPP-së.

Autoriteti kontraktues me datë 19 Maj 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues "Poligoni i shenjëtarisë Katana'' sh. p. k me datë 22 Maj 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori ekonomik ankues "Sodex Group" Sh. p. k me datë 22 Maj 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet pjesërisht me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 30.05.2017, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesit i OE ankues, ekspertët e OSHP-së, vëzhguesit nga D Plus Isuf Zejna ku shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues "Katana" sh. p. k z. Jusufi ka deklaruar: Në ankesën tonë shumica e pretendimeve janë pranuar nga ekspertët shqyrtues, veçanërisht neni 69 par. 2 pika 4, pika 5 edhe shkelje të kërkesave të dosjes FDT par. 9. 2 si dhe aneksi 1 për specifika, për mundësi teknike ose profesionale. OE i rekomanduar për kontratë nuk ka referencat dhe certifikatat. Komisioni i caktuar nga AK-ja për rivlerësim të dosjes, ka kontaktuar me laboratorin që ka lëshuar dokumentet që janë pranuar si certifikatat dh testet dhe ka kontaktuar kompaninë GK Professional e cila ka lëshuar dy referenca të cilat i ka pranuar AK-ja, si të mjaftueshme për aftësi teknike profesionale për OE të rekomanduar për kontratë.

Nga ajo korrespodencë është vërtetuar edhe me kopjet e emalit nga laboratori që ka lëshuar ato dokumente që një në numër i atyre dokumenteve thuhet se nuk janë lëshuar nga ai laborator. Po ashtu një dokument që është pranuar si certifikatë, në fund të vet dokumentit shkruan se nuk mund të përdoret si certifikatë. Ndërsa sa i përket dy dokumenteve që janë pranuar si referenca, sipas LPP-së, kur furnizimet janë bërë për ndonjë AK, Kosovë apo jashtë, dëshmi për pranimin e këtyre mallrave merren certifikatat e dorëzimit të nënshkruara apo anashkaluar nga ky autoritet publik. Dokumente tilla në OE të fitues nuk ka. Ato që janë pranuar si referenca janë lëshuar nga përfaqësuesi i prodhuesit për vet veten. Kjo shihet nga kopjet e atyre dokumenteve që gjenden në dosje. Sa i përket pretendimeve të OE ankues "Sodex Group" për dokumentet në dosjen tonë të tenderit, AK-ja, i ka pranuar ato si valide pa kërkuar sqarime, dhe arsyetimi i AK-se, është i vlefshëm që vërtetohet nga dokumentet që ne kemi kërkuar nga laboratori që ka lëshuar certifikatën që i kemi dërguar edhe ekspertit në gjuhë shqipe. Në sqarimin e autoritet që ka lëshuar dokumentin "Zyra e Bajernit për Masë dhe Peshë – Zyra e shërbimit, zyra për gjuajtje me Mellrichstad".

Sqarimi i këtij instituti në fund thotë "raporti i inspektimit vlerësues 14S267-02#, e konfirmon për mbushjen e nivelit 2 thikë sipas NIJ standard- 0115.00, ky raport testues është bazuar me certifikatën. Do thotë sikur AK-ja të ketë nevojë për sqarim, atë sqarim do e kishin pas në rivlerësim. Pretendimi i dytë i OE "Sodex Group", për garancion për 10 vite, është pretenduar se garancioni është dhënë vetëm kundër plumbave e jo edhe kundër therrjes. Ne kemi edhe sqarimin e prodhuesit se garancioni është dhënë për gjitha shtresat mbrojtëse balistike, edhe për plumba edhe kundër therjes, për 10 vite si paketë. Kjo me që shtrojat nuk ndahen dhe janë një pako, me garancion 10 vite, ndërsa pjesët

që hiqen mbështjellësi dhe bezi kanë garancion 2 vite. Të tillë e ka kuptuar edhe AK-ja. Sikur të kishte kërkesë për sqarim atë do e bënim me kohë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues:"Sodex Group" z.Avdiu ka deklaruar: Ne me ankesën tonë kemi dorëzuar të gjitha pretendimet që besoj se janë lexuar dhe kemi lexuar me vëmendje raportin e ekspertëve. Ne pajtohemi me raportin e ekspertëve në pikat ku është vërtetuar se OE i rekomanduar për kontratë nuk është i përgjegjshëm e po ashtu edhe Katana nuk është i përgjegjshëm. Në raportin e ekspertit nuk është cek një pikë që nuk është shqyrtuar fare se OE i jonë është e përgjegjshme në këtë aktivitet të prokurimit. Në këtë tender kemi dorëzuar deklaratën për specifika teknike ku zotohemi se oferta jonë përputhet me kërkesat e AK-së, dhe do i liferojmë mallrat sipas kërkesave në dosje të tenderit.

Kemi plotësuar specifikat që kemi ofruar në tabelën e kërkuar, dhe shihet qartë se shenja POLICE është e përfshirë në ofertë. Po ashtu ne jemi furnitor qe disa vite dhe kemi të përbëj me shenja të policisë dhe furnizojmë pjesë tjera për uniforma. Në specifikim teknik të bërë nga AK-ja, nuk është caktuar fare lloji i fontit, madhësia shkronjave në pjesën e përparme, në pjesën e pasme, ngjyra e shkronjave dhe nëse shkronja apo prapaskena duhet të jenë fluoreshente. Në ofertë kemi dorëzuar edhe katalog ku qartë shihet se shenja POLICE në pjesën e përparme dhe pasme është e përfshirë.
Po ashtu në përshkrimin e artikullit është vet AK-ja, që ka shënuar që duhet të përfshihet në çmim edhe shenja POLICE. Me këtë pretendojmë se kompania jonë është e përgjegjshme dhe duhet si e tillë të shpallet fituese.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-se, z. Gerguri ka deklaruar: Si përfaqësuesi i AK-së, deklaroj se në dy fazat si në vlerësim dhe rivlerësim AK-ja, ka respektuar procedurat ligjore dhe në pajtim me autorizimet ka kryer detyrën e vet brenda për brenda dispozitave ligjore. Në rastin e parë dhe të dytë AK-ja, ka përzgjedh – ka rekomanduar OE "All Zone" sh .p .k si fitues i këtij tenderi të madh - të hapur, që në rastin konkret ka rezultuar që kriteri përcaktimit të këtij OE ka qenë çmimi më i ulët.
Ne edhe në fazën e parë dhe dytë e kemi konstatuar se tenderi i përgjegjshëm OE "All Zone" ka qenë i përgjegjshëm teknikisht dhe administrativisht. Sa i përket pretendimeve ankimore që i kemi pranuar me shkrim që u paraqitën në seancë nga OE-të, si AK konsiderojmë se janë të paqëndrueshme dhe në vete përmbajnë komplet interpretime juridike - administrative që në asnjë mënyrë nuk e prekin standardin e përgjithshëm e që mund të atakojnë nëse është bërë shkelje në proces të vlerësimit. E siguroj panelin se komisioni i AK-se, në dy fazat ka kryer punën në mënyrë të pavarur dhe pretendimet e ekspertit konsiderojmë se janë subjektive, pasi ka ra në ndikim të pretendimeve të OE-ve që kanë paraqitur në ankesë apo edhe seancë konsultative. Ne qëndrojmë pranë vendimi të komisionit rivlerësues, dhe janë të paqëndrueshme ankesat e OE-ve si dhe mendimi i ekspertit.
Anëtari i panelit z. Salihu pyeti përfaqësuesin e AK-së a kanë qenë komisionet vlerësues profesionist në këtë lami?. Në përgjigje z. Gërguri deklaroj: Në rastin konkret në dy komisione janë anëtar që vijën

nga fusha caktuar (forcat Speciale) që kanë njohuri shumë të mëdha për produktin që zhvillohet aktiviteti i prokurimit.

Në vazhdim përfaqësuesja e AK-së, znj. Bllaca deklaroj: Në dosje te tenderit dhe ne njoftim për kontratë është kërkuar kompania të ketë referencë me vlerë të caktuar. OE i rekomanduar ka ofruar një referencë me vlerë të parashikuar që tejkalon vlerën e kërkuar. Lëshuesi i referencës është kompani në Francë dhe nuk është kompania prodhuesi në Belgjikë. Kërkesa jonë ka qenë vetëm referencë me qarkullim, pa detaje tjera për përdorues të fundit, raport pranimit përdoruesit fundit etj. Sa i përket certifikatave, OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar rreth 200 certifikata. Ne si AK, i kemi vërtetuar vetëm certifikatat që i kemi kërkuar. Certifikata me numrat e fundit 4750 ka pjesët terja të bashkangjitura, si dhe 4751 me pjesë të bashkangjitura, dhe certifikata 15LBR/1597. Këto tri certifikata janë të kompanisë TNO që janë dërguar bash me certifikatën TNS dh nuk është kompanie njëjtë mirëpo janë përvjedhë në dosje. Po ashtu janë dërguar katalogët. Po ashtu kompania ka kthyer një emali që thotë se vërteton këto tri dokumente, mirëpo jo katalogun dhe dokumentin tim tjetër pasi ceka nuk janë dokumente të saj. Në dosje te tenderit është specifikuar se kompania duhet përshkruaj Brendin. OE i rekomanduar ka ofruar një katalog me cilin kemi mund të bëjmë vlerësim detal. E gjetura nga eksperti teknik është për mendimin tim banalitet.

Në vazhdim përfaqësuesi i OE "All Zone" ka deklaruar: Sa i përket pretendimit të OE "Katana", për referenca, kjo është hedh nga vet ekspertët. Sa i përket pretendimit se raportet testuese nuk janë vërtetuar nga laboratori TNO, duhet të theksohet se janë dy laboratorë që kanë dorëzuar teste për këtë aktivitet. Është ai TNO, që ka dorëzuar teste për anti plumbin e brendshëm dh të jashtëm, dhe është laboratori NTS që ka dorëzuar testet për therje me thikë. Arsyeja pse është një laborator tjetër është se testet për therje me thikë nuk kryhen në Evropë dh kryhen vetëm Amerikë. Këto teste gjithashtu janë vërtetuar nga NTS. Sa i përket pretendimeve të ekspertit se nuk kemi certifikatë konformitetit për anti plumb të jashtëm, mund të sqaroj se janë dorëzuar certifikatat e konformitetit për secilin test dhe në dosje janë vendosur para secilit test. E ftoj panelin të shikoj provën 3, ku janë renditur certifikatat e konformitetit, e para është certifikata për therje me thitë KR1, e dyta është për anti plumb të brendshëm, dhe e treta për anti plumb të jashtëm. Këto janë shumë të qarta dhe nuk ka asgjë kontestuese. Sa i përket referencës, referenca është lëshuar për "Seyntex" nga Belgjika, i cili po ashtu prodhuesi me të cilin ofertojmë. Ndërsa kompania GK profesional ka konfirmuar se kanë pranuar produktet e Seyntex dhe ka lëshuar referencë për të. Sa i përket pretendimit se nuk dihet sipas specifikimit teknik se çfarë produkti është ofruar, lus panelin të shikoj provën 2 që është katalogu i produkteve të ofruar.

Katalogu ka të dhënat më të detajizuara të mundshme për secilën pjesë të anti plumbit. Po ashtu konstatimi ekspertit për raporte testimit, duhet të cek se raportet që kemi ofruar kanë pas për qëllim për të vërtetuar deklaratën e prodhuesit se produktet e ofruara munden me i ndal kalibrat e plumbave që janë specifikuar në raport është shumë e qartë se prodhuesi dhe kontraktori i testimit është Seyntex. E ftoj panelin të shikoj provën nr. 4 ku janë dy apo tri faqe të secilit raport, tek "sampels specifications",

specifika e mostrës. Këtu janë të dhënat që shkruhen për mostrën që është dorëzuar për tu bërë testim. Kur bëhen testet nuk ka model siç pretendojnë ankuesit. Laboratorit çka i intereson është që pjesa balistike që duhet të ndal plumbat e kalon testin të cilin pretendon prodhuesi se e kalon. Si e dhënë vendoset vetëm një numër identifikues për mostër dhe të dhëna për trashësi peshë dhe numër të shtresave. Pretendimi se nuk është specifikua modeli këtu nuk duhet të merret parasysh pasi vetëm pllaka shkon në testim, dhe nuk shkon i gjithë komplet jeleku në testim.

Gjatë prezantimit në seancë ekspertit shqyrtues-teknik z. Kurtishaj deklaroj: Bazuar në pretendimet e dy OE-ve ankues, ne kemi dhënë përgjigjet për secilin pretendim ankimor bazuar në dokumentacionin në dispozicion. Nuk jemi pajtuar me AK-ne, për përshkrimet teknike të OE të rekomanduar për kontratë bazuar në kërkesat e dosjes që kanë qenë.
Në dosje është kërkuar përshkrim teknik për produktin të cilin është kërkuar dhe OE ka pas obligim të plotësoj specifikimin teknik me gjitha detajet teknike të produktit për cilin ka ofertuar.
OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dhënë asnjë detal në specifika teknike për produktin që ka ofruar por komplet kërkesën AK-se, ka ofruar dhe e ka qitur në pjesën ku ka pas obligim ta plotësoj. Përshkrimi i produktit të ofruar prej OE të rekomanduar është dhënë në katalogun që i ka bashkangjitur dosjes. Aty jepen detaje teknike të jelekut duke përfshirë edhe llojin e jelekut që ka ofruar. Certifikatat e kërkuara dhe raportet testuese laboratorike për produktet që ka ofertuar nuk korrespondojnë me llojin e produktit i cili është në katalogun e OE të rekomanduar për kontratë. Certifikata për nivelin mbrojtës nga shpimi, që është kërkuar në dosje e ashtuquajtur "KR1", nuk i përgjigjet po ashtu produktit të ofruar në katalog. Sa i përket pretendimeve ankimore të OE ankues "Sodex Group", lidhur me ofertën e OE ankues "Katana", ne i kemi dhënë mendimet ku njëri prej pretendimeve ankimore ka rezultuar të jetë i bazuar, kemi pas edhe seancë konsultative me OE "Katana" dhe të AK-së, dhe vet përfaqësuesi i OE "Katana" nuk ka mund të argumentoj para nesh certifikatën për nivelin e mbrojtjes nga shpimi KR1 për artikullin anti plumb i brendshëm. Lidhur me këtë pas dorëzimit të raportit tonë ne kemi pranuar një emali nga OE "Katana", i cili bashkangjet një certifikatën të tillë, dhe është i përkthyer edhe në gjuhë shqipe.

Për pjesën administrative mundet eksperti shqyrtues të jap mendim, por ne bashkërisht kemi shqyrtuar lëndën dhe kemi pretenduar si pretendime të pabazuara të OE-ve ankues për pjesën administrative. Po ashtu nuk pajtohemi me konstatimin e zyrtarit nga AK-se, z. Gërguri që thekson se ekspertët kanë qenë subjektiv me rastin shqyrtimeve të pretendimeve ankimore të dy OE-ve ankues, për një fakt të vetëm se ne shqyrtimin dhe analizën e kemi bërë sipas dokumenteve në dispozicion dhe kërkesave ligjore që duhet ti respektojmë, dhe absolutisht nuk jemi palë e interesit në ketë rast, pasi nuk jam as fitues as humbës dhe palë anën OE dhe AK.

Anëtari i panelit z. Sylejmani pyeti ekspertin teknik se te përshkrimi çka ka ofruar OE i rekomanduar dhe çka ka qenë kërkesa e AK-së? dhe se për çfarë produkti ka ofruar testin OE i rekomanduar për kontratë. Në përgjigje z. Kurtishaj deklaroj: OE nuk ka bërë asnjë përshkrim të vetmin dhe vetëm ka bart specifikat e AK-së. Artikulli i OE të rekomanduar është dhënë vetëm në

katalog, dhe OE ka ofruar një certifikatën konformitetit e cila nuk e përcakton llojin e produktit që OE ka ofruar në katalog.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi OE z. Jusufi deklaroj: Në referencë nuk thotë se malli i është shitur GK profesional, por se është shitur përmes GK profesional dhe përmes saj i bie që është partner dhe rrjedhimisht i janë shitur dikujt tjetër. Sa i përket listës së projekteve OE "All Zone" nuk kanë përvojë në këtë lëmi, mirëpo kërkesa ka qenë lista projekteve, dhe OE ka ofrua një listë të projekteve mirëpo që nuk kanë të bëjnë me këtë veprimtari. Ato që ceku OE fitues për prodhuesin Seyntex, ato janë referenca që i kanë lëshuar vetes. Në seancën konsultative dy dokumentet që ka konfirmuar, dy dokumentet që ka konfirmuar instituti 4750 dhe 4751 shkruan se janë raporte të testimit, dhe në fut në to shkruan se nuk mund të përdoren si certifikatë. Dokumenti i tretë konfirmohet se është lëshuar nga TNO dhe ky dokument janë për anti plumb të jashtëm. Nga TNO nuk ka konfirmim për anti plumb të brendshëm. Në specifikacionet në pjesën aneksi 1, kërkohet të përcaktohet çfarë lloji materiali është përdor, çfarë lloj mbrojtje etj. Ato fare nuk janë saktësuar në anën e djathtë, kjo është me rëndësi pasi me ato të dhëna në aneks 1 duhet bërë vlerësimi i dokumenteve tjera teknike. Pretendimi se vetëm pllaka dërgohet në laborator, me rastin kur bëhet testimi niveli i katër bëhet vetëm kur gjitha pjesët përdoren bashkë. Në broshura shkruan Covert Vest, dhe Overt Vest që janë dy lloje anti plumbi. Nëse këto i marrim si emërtime të modeleve që mungojnë te aneksi 1, atëherë duhet ti gjejmë në certifikata dhe teste. Pavarësisht prodhuesit duhet cekur cili model testohet pasi Seyntex prodhon disa modele. Ne qëndrojmë pranë gjitha pretendimeve ankimore dhe i propozojmë panelit që lëndën ta kthej në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi OE z. Avdiu deklaroj: Qëndrojmë pranë ankesës dhe pretendimeve ankimore dhe i propozojmë panelit të aprovoj ankesën tonë dhe lëndën ta kthej në rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-se, z. Gerguri deklaroj: Në seancë konsultative që kemi pas ka qenë vetëm OE "Katana". Nuk ka qenë OE "Sodex" e as OE i rekomanduar për kontratë. Pse kjo ka qenë kështu nuk e din dinë ndoshta ekspertët. Në seancë referencat janë marr të njëanshme nga një kompani, dhe gjitha provat e OE fitues që dha në seancë dhe OE "Sodex" nuk kanë qenë të dhëna pranë ekspertit. Eksperti në rastin konkret konsideroj se nuk ka trajtuar njëjtë OE-të ankues dhe OE të rekomanduar për kontratë pasi nuk kanë pas mundësinë për të dhënë sqarime. Si përfaqësues i AK-së, deklaroj se qëndrojmë pranë vendimit të komisionit të vlerësimit dhe standardet e kërkuara me specifkacione janë përmbushur. Nuk ka mundësi me pajisje të përmbushet 100% asnjë tender, asnjë kompani. Në këtë aktivitet të prokurimi kushdo që të shpallet fitues do ketë një OE tjetër që do ankohet pasi kanë interesin material. Policia i Kosovës ka për siguri, dhe nëse OE-të përdorin hapësirat ligjore për tu ankuar do e lënë Policinë e Kosovës pa jelek anti plumb. Deri tani nuk kemi pas viktima mirëpo sot policët bartin jelek me afat të skaduar.

I prezantoj panelit shqyrtues edhe mostrat e tre OE-ve ku mund të shihni se dallimi mes mostrave të tre OE-ve është minimal mos të thënë inekzistent. Ne qëndrojmë pranë vendimit të AK dhe i propozojmë panelit shqyrtues të vërtetoj vendimin e AK-së si të bazuar.
Në fjalën përfundimtare znj. Bllaca deklaroj: AK-ja, i ka shpall dy OE të përgjegjshëm e jo siç pretendon eksperti shqyrtues se asnjë nuk janë të përgjegjshëm. Mirëpo oferta OE "Katana" është 700.000 € më e lartë se ajo e OE të rekomanduar për kontratë.

Në fjalën përfundimtare z. Kurtishaj deklaroj: Ligji i prokurimit neni 114 parasheh se ekspertët munden me thirr në konsultim palën ankuese dhe secilin zyrtar të AK-se. Ne kemi thirr në këtë rast një palë dhe tjetrën jo, mirëpo nuk dëgjova nga pala që nuk janë ftuar, te ketë pas ankesë, dhe OE "Sodex" nuk është ftuar pasi i njëjti është shpall i papërgjegjshëm nga AK-ja. Qëndroj pranë raportit të ekspertizës dhe konstatimeve të dhëna në raport.

Në fjalën përfundimtare eksperti deklaroj: ''Qëndroj në tërësi pranë raportit të ekspertizës, si dhe pranë konstatimeve dhe rekomandimeve të dhëna në raportin e datës. 18.05.2017"

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, raportin e ekspertit shqyrtues, përgjigjet e palëve në procedurë vjen në përfundim se operatorët ekonomik ankues "Sodex Group" dhe Poligoni i shejtarisë "Katana", janë të papërgjegjshëm. OE ankues Poligoni i Shenjëtarisë "Katana" Sh.P.K është i pa përgjegjshëm sepse nuk a ka ofruar në dosjen e tij Certifikatën për nivelin e mbrojtjes nga shpimet - KR1. Prandaj, paneli shqyrtues konstaton se në aspektin teknik - profesionale operatori ekonomik ankues Poligoni i Shenjëtarisë "Katana" Sh.P.K është i papërgjegjshëm. Poashtu gjate seancës dëgjimore u vërtetua fakti se OE ankues "Sodex Group", është i papërgjegjshëm për arsye se nuk i ka plotësuar të gjitha specifikat teknike me saktësisht në jelekun antiplumb nuk e ka ofruar mbishkrimin "Police" të cilat është dashur ti ketë në jelekun antiplumb. Duke pasur parasysh faktet e lartpërmendura, rezulton se të dy operatorët ekonomik ankues në këtë aktivitet të prokurimit janë palë pa interes juridik material konform nenit 4 paragrafi 1.26 i LPP-së, përkitazi me nenin 111 paragrafi 1.5 dhe 1.8 i LPP-së, pasi që në asnjë mënyrë këta dy operatorë ekonomik ankues nuk kanë mundur të dëshmojnë se shkelja e supozuar i është kërcënuar të ju shkaktojë dëme këtij operatori ekonomik dhe njëkohësisht me këto rrethana dhe fakte, të njëjtit operator në asnjë variant nuk kanë mundur të shpallen fitues të këtij tenderi, pasi që të dy janë të papërgjegjshëm.

Paneli shqyrtues, lidhur me pretendimet ankimore të OE-ve ankues që kanë të bëjnë me ofertën e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, konstaton dhe vlerëson se gjatë seancës dëgjimore, ku ishte prezent edhe përfaqësuesi i OE të rekomanduar për kontratë i cili gjatë prezantimit në seancë ofroj prova të reja në lidhje me certifikatat e sigurisë për jelekët antiplumb, andaj paneli shqyrtues duke u bazuar edhe në këto dëshmi konstaton dhe vlerëson se konform nenit 59.4 pikës (ii), mund të këtë devijime të vogla. Paneli shqyrtues poashtu gjatë analizimit të provave dhe sqarimeve të dhëna nga ana e përfaqësuesve të autoritetit kontraktues – Policisë së Kosovës, i cili gjatë seancës dëgjimore

deklaroj se në vlerësim të ofertave përkatësisht mostrave të dorëzuara kanë marr pjesë pjesëtar të Policisë së Kosovës – njësive speciale dhe njëherit i njëjti potencoj nevojën që ka Policia e Kosovës për jelekët antiplumb, andaj, paneli shqyrtues me rastin e vendim marrjes, duke pas parasysh që në vlerësim kanë marr pjesë pjesëtarët e policisë të forcave speciale si profesionist dhe duke pasur parasysh se OE i rekomanduar për kontratë është me çmim më të ulët prej 700.000.00 € vendosi që të ja fal besimin dy komisioneve vlerësuese profesionale të autoritetit kontraktues dhe njëherit Paneli shqyrtues duke pas parasysh nevojën që ka Policia e Kosovës për jelekët antiplumb ngase shumica e jelekëve antiplumb Policët e Kosovës i bartin me afat të skaduar dhe duke pasur parasysh sigurinë-jetën e policëve, vendosi që konform nenit 104.4 të LPP-së, të merr parasysh edhe interesin publik. Krejt në fund Paneli shqyrtues, konstaton dhe vlerëson se është respektuar neni 60 i LPP-së i cili njëherit ka qenë edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës – Çmimi më i ulët. Prandaj në këtë rast është respektuar edhe neni 1 dhe neni 6 i LPP-së, pasi që qëllimi i ligjit për prokurim publik është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë

Andaj, Paneli shqyrtues duke u bazuar në të gjitha faktet e lartpërmendura Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

Z. Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – 'Policia e Kosovës"

1x1 OE "Poligoni i shenjëtarisë Katana'' Sh. p. k – Obiliq"

1x1 OE "Sodex Group"Sh. p. k- Prishtinë"

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në Web- faqe të OSHP-së.